

Bashkësia Islame e Kosovës vlerëson se akti i djeshëm i djegies së flamurit në të cilin është edhe dëshmia islame - shehadeti, është veprim i papranuar dhe në kundërshtim me traditën tonë të tolerancës e mirëkuptimit.

Lexojeni të plotë reagimin e BIK-ut:

Akti i djeshëm i djegies së "flamurit" nga një grup i të rinjve në të cilin është edhe dëshmia islame - shehadeti, është veprim i papranuar dhe në kundërshtim me traditën tonë të tolerancës e mirëkuptimit. Është e vërtetë që ky flamur padrejtësisht po keqpërdoret nga ISIS, organizatë terroriste e cila vepron gjoja në emër të myslimanëve. Mirëpo kjo assesi askujt nuk i jep të drejtë që të përdhosë simbolet islame apo të çfarëdo feje tjetër.

Me kohë e kemi thënë dhe e kemi sqaruar se ISIS, nuk vepron sipas mësimëve islame dhe as që është zgjedhur e mandatar nga myslimanët për përfaqësim. Jemi të bindur që veprimet e tyre shpejt do të marrin përgjigjen adekuate nga populli i Irakut dhe i Sirisë në bashkëpunim me botën demokratike.

Ftojme të rinjtë tanë që të jenë të kujdesshëm e të matur në veprimet e tyre dhe mos të bien pre e fushatave që më shumë mund të sjellin debate, konfuzion e paqartësi sase qëllimi i tyre për distancim nga veprimet e ISIS. Rikujtojmë se në emër të distancimit nga ISIS, është e papranueshme nëpërkëmbja dhe përdhosja e simboleve islame.

Po ashtu ftojme edhe besimtarët tanë që të mos bien pre e veprimeve të pamatura të disa të rinjve tanë, ku kemi bindjen se këta të rinj nuk kanë dashur që të djegin dëshminë "Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi a.s. është i dërguar i tij", por kanë dashur të djegin fotografinë e kriminelit Bagadatit dhe krimet e tij mbi popullatën e pafajshme. Ne si popull solidarizohemi me vuajtjet e popullatës civile në Irak e Siri, dhe në të njëjtën kohë dënojmë veprimet kriminale të asaj që quhet ISIS.